



## THIRRJE PËR APLIKIME

Konsulent për Zhvillimin e Koordinimit të Instrumentit Kombëtar të Monitorimit

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) po kërkon të kontraktojë një Konsulent për Zhvillimin e Koordinimit të Instrumentit Kombëtar të Monitorimit.

Qëllimi i shërbimit: Konsulenti kërkohet të:

- 1) moderojë gjashtë aktivitete të organizuara me oficerë policie (dy), me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve / punonjës socialë (dy) dhe me pale të tjera të interesuara (dy) për shqyrtimin e treguesve të mjeteve të monitorimit;
- 2) shqyrtojë treguesit e mjetit të monitorimi, bazuar në takimet me grupet e punës;
- 3) reflektojë feedback-un e marrë në draft – mjetin e monitorimit;
- 4) alokojë treguesit individualë;
- 5) përmirësojë mjetin e monitorimit; dhe
- 6) feedback-u i marrë nga takimet e grupeve të punës duhet të ndahet me konsulentin e ardhshëm përgjegjës për shkrimin e raportit 2019/2020 dhe stafit të projektit të QNL-së

Thirrja është nisur në kuadër të Veprimit "Balkans Act Now! - BAN III ", një projekt rajonal i financuar nga Bashkimi Evropian.

Termet e Referencës për këtë detyrë gjenden [KËTU](#).

Aplikantëve të interesuar u kërkohet të kontaktojnë Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare në adresën:

"Rruga Vaso Pasha, P.12, Shk.1, Ap.1, Tiranë", për të kërkuar informacion të mëtejshëm dhe për të marrë paketën e dokumenteve përkatëse.

Afati i fundit për të kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktues - 21 ditë përpara afatit të dorëzimit të aplikimit;

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është 11 korrik 2019, ora 16.00.

Njoftimi i fituesit - 12 korrik 2019 dhe përgjigja ndaj kandidatëve - 12 korrik 2019.